

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN Departamenti i Përgjithshëm përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Ramiz Azizi me procesmbajtsen Luljeta Tahiri, në lëndën penale ndaj të akuzuarit M. J. nga fshati P., për shkak të veprës penale legalizimi I përmbajtjes së rreme nga neni 403 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1201/15 e datës 23.09.2015, të cilën e përfaqësonte prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, verbal dhe publik më datën 30.11.2016 mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari M. J. nga i babai P. dhe nëna V., e lindur N., i lindur me datë ... në Gj. e tani me vendbanim ne P., ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i katë fëmijëve, i papunë i gjendjes së varfër ekonomike, S., Shtetas i Republikës së Kosovës,

Është fajtor Sepse

Me datë ..., në kohë të papërcaktuar, në Qendrën e Regjistrimit të automjeteve në Gjilan, të pandehurit R. K. e M. J., e kanë regjistruar automjetin e markës ... me nr. identifikues ..., në at mënyrë që fillimisht në vitin ..., i pandehuri R. K. e ka falsifikuar librezën e qarkullimit me nr. serik ..., me targa të regjistrimit ..., të cilin automjet i pandehuri R. K. vazhdimisht e ka regjistruar me tabela të regjistrimit ..., e më pas edhe i pandehuri M. J. këtë automjet e ka vazhduar regjistrimin në ... në Gjilan, ndërsa pasi që zyrtarët e autorizuar policor, me rastin e kontrollimit të dokumenteve-lejes së qarkullimit, e cila është prezantuar, kane dyshuar se e njëjta është e falsifikuar, pas hetimeve të zhvilluara, është konstatuar se librezë e qarkullimit me nr. serik ..., është plotësisht e falsifikuar, dhe në këtë mënyrë të pandehurit e kanë vu në lajthim organin kompetent për ta vërtetuar një qështje të pavërtetë.

- me çka në bashkëveprim kanë kryer veprën penale legalizimi I përmbajtjes së rreme nga neni 403 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,23,49,50,51,52 ,69 e 73 të KPRK-ës si dhe të neneve 365, 451 e 463 të KPRK-ës, të akuzuarit i shqipton.

DËNIM ME KUSHT

Kështu që të akuzuarit M. J. ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **150 (njëqindpesdhjetë) ditëve**, të cilin dënim nuk do ta vuaj nëse në afatin prej **1 (një) viti**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, e në të kundërtën ai do të revokohet.

Të akuzuarit i shqiptohet edhe dënimi plotësues i konfiskohen dy lejet e qarkullimit CRA ... dhe VRD ... dhe tabelat e regjistrimit me nr.

Pala e dëmtuar ... nga Gj., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro, në emër të paushallit gjyqësor si dhe në emër të hargjimeve procedurale shumën e përlogaritur me llogarinë përfundimtare të kësaj gjykate, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan e ka ngritur aktakuzën e saj PP.II.nr.1201/15 të datës 23.09.2015 kundër të akuzuarve R. K. e M. J. për shkak të veprës penale legalizimi i përmajtjes së rreme nga neni 403 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Procedura ndaj të akuzuarit të parë R. K. është kryer dhe gjykuar me aktgjykimin e kësaj gjykate P.nr.978/15 të dt.19.04.2016.

Në shqyrtimin fillestar të datës 30.11.2016 Prokurori i Shtetit Kujtesa fazliu në fjalën e saj përfundimtare, pohoi se pasi që e akuzuara e pranoi fajësinë, kërkoj që e njëjta të shpallet fajtores për veprën e cila i vihet në barrë në aktakuzë, asaj ti shqiptohet dënimi meritor i paraparë me ligj.

Në fillim të shqyrtimit fillestar pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari M. J.pohoi se e kam kuptuar aktakuzën në tërësi si dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar se e pranoj në tërësi dhe vullnetarisht fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale e cila sipas kësaj aktakuze më vihet në barrë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të prokurorit dhe të akuzuarit konstatoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 paragrafi 1 të KPPRK-së, për pranimin e fajësisë, ngase e akuzuara e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi është bërë vullnetarisht nga e akuzuara, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza me materialet që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike:

Se i akuzuari M. J.me dashje e paramendim e ka shkaktuar aksidentin në fjalë duke e kryer veprën penale legalizimi i përmajtjes së rreme nga neni 403 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin M. J.për shkak të kryerjes së vepres penale legalizimi I përmajtjes së rreme nga neni 403 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, ngase veprimet e të njëjtës i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjëse penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit së lartcekur gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform nenit 73 të KPRK-së, ku si rrethanë lehtësuese gjykata gjeti se ajo e ka pranuar vullnetarisht fajësinë, se atë e ka kryer nga pakujdesia, se më parë nuk ka kryer vepër tjetër penale, ndërsa si rrethanë rënduese dëmin e shkaktuar të dëmtuarës ... nga Gj. .

Sipas bindjes së lirë të kësaj gjykate caktimi i dënimit me kusht ndaj të akuzarit , është marrë duke i pasur për bazë të gjitha rrethanat e lartcekura është dënim i të drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuares si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësorë është marrë në bazë të nenit 451 të KPPRK-së

Vendimin mbi kërkesën pasurore juridike është marrë mbi bazë të nenit 463 të KPPRK-së, ndërsa aim bi konfiskimin e librezës dhe tabelave është I bazuar në nenin 62 e 69 të KPRK-së.

Duke u bazuar nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.851/16 më datë 30.11 2016

Sekretare juridike
Florentina Ademi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ramiz Azizi

KËSHILLA JURIDIKE : *Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.*

